

**STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË**  
**“OM GREEN ENERGY” ,SHPK**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr 9981 datë 14.04.2008 “ Për shoqëritë tregëtare, dhe në ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2008 “ Për QKR dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë tregtare, me vullnetin tim të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-theelimi dhe statute të shoqërisë.

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit.**

Sot me datë 17/092022 unë, themeluesi Muharrem Bardhoci, i biri i Riza-it, lindur me 07.07.1960, në Kukës, dhe banues në Tiranë , Rruga “Agron Jano” Godina Nr. 7., i pajisur me nr. personal G00707039R, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**OM GREEN ENERGY**”,SHPK

**NENI 2: Personaliteti Juridik**

2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar.

2.2 Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi I saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.3 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

**NENI 3: Forma e Shoqërisë**

3.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, derisa me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset shndërrimi i formës ligjore.

**NENI 4: Objekti**

4.1 Shoqëria “OM Green Energy” SHPK, do të ketë si objekt të veprimtarisë:



“Implementimi dhe menaxhimi I projekteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike dhe gjithë llojeve të tjera të prodhimit të energjisë dhe veprave ndihmëse në teritorin e Republikës së Shqipërisë. Prodhim Energjie Fotovoltaike, Hidrike, Solare , etj. Shit-Blerje Energjie Fotovoltaike, Solare Hidrike, dhe furnizimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike ndaj të tretëve sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Import Eksport, i të gjitha llojeve të materialeve dhe transport. Shitje-blerje e tokave për zhvillimin e parqeve fotovoltaike, ndërtimi dhe menaxhimi i zonave ekskluzive tregtare për zhvillimin e parqeve fotovoltaike. Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha lejeve dhe liçencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 5: Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria “OM Green Energy” SHPK, kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin e saj deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### **NENI 6: Selia**

6.1 Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga “Agron Jano” Godina Nr. 7. Me vendim të Administratorit selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj Brenda dhe jashtë Shqipërisë.

#### **NENI 7: Vula e Shoqërisë**

7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emërtimin tregtar ose iniciale.

## **KREU II**

### **KAPITALI**

#### **NENI 8: Kapitali Themeltar**

8.1 Kapitali themeltar fillestar I shoqërisë është 100,000 ( njëqindmijë) lekë.

8.2 Ortaku themelues Muharrem Bardhoci, zotëron 1 kuotë me vlerë të ërgjithshme 100,000 ( njëqindmijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar.

8.3 Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër ose në arkën e shoqërisë.

**NENI 9: Kuotat, të drejtat e lidhura me to**

9.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve.

**NENI 10: Kuotat, Fitimi, transferimi I kuotave**

10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet knributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashigimisë, dhurimit, apo çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

**NENI 11: Organi Vendimmarrës (Asambleja e Përgjithshme). Kompetencat.**

11.1 Asambleja e Përgjithshme është ogani i vetëm vendimmarrës i shoqërisë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) ndryshiin e statutit
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit
- ç) emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike.
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera administrative
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statut.

**NENI 12: Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë Përgjithshme.**

12.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi bëhet nga administrator i shoqërisë.

12.2 Asambleja e përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit për të vendosur për çështje të tilla si miratimi I bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi I raportit të auditimit të shoqërisë.

12.3 Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë apo edhe në një vend tjetër të njohur nga ortaku I vetëm.

12.4 Vendimet merren nga asambleja e Përgjithshme.

### **NENI 13 Përfaqësimi në Asamble.**

13.1 Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje në rastet kur e ka të pamundur pjesmarrjen personalisht në mbledhje nga një person i tretë ose dhe një ortak tjetër shoqërie.

Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar qartë kompetencat e përfaqësuesit si dhe të drejtat e tij lidhur me vendimarrjen në mbledhje.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

## **KREU IV ADMINISTRIMI**

### **Neni 14. Administratori i shoqërisë.**

14.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme. Administratori i shoqërisë do të jetë Znj. Feride Bardhoci, e bija e Banushit, lindur me 01.09.1965 në Kukës, banuese në Tiranë, Rr. "Agron Jano" Banes Nr. 7, e pajisur me ID me nr.personal G 55901208 O. Afati i ushtrimit të detyrës është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje.

### **Neni 15. Të drejta dhe detyrimet e Administratori. Përgjegjësitë.**

15.1 Administratori ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) Kryen të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.
- b) Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë Brenda kompetencave të parashikuara në statut apo dhe në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

- c) Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë.
- d) Jep urdhëra dhe udhëzime punëmarrëve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë.
- e) Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare.
- f) Të raportojë para asamblesë së përgjithshme sa herë që asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- g) Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme.
- h) Ti paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme Asamblesë Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe përgjigjet për to.
- i) Të ushtrojë të drejtat dhe detyrime të parashikuara nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”.
- j) Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera në fuqi.

#### **Neni 16. Mbarimi i mandatit të Administratorit.**

16.1 Mandati i Administratorit përfundon:

- a) me mbarimin e afatit.
- b) me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme.
- c) kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.

### **KREU V**

#### **VITI FINACIAR, PRISHJA E SHOQËRISË**

#### **Neni 17. Viti Financiar.**

17.1 Veprimet financiare mbyllen në 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit të hartuar konformë ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

#### **Neni 18. Prishja dhe likuidimi.**

18.1 Shperndarja dhe prishja e shoqërisë mund të bëhet:

- a) me vendim të Asambles së Përgjithshme

- b) me hapjen e procedurave të falimentimit.
- c) Për shkaqe të tjera të parashikuara në legjislacionin Shqiptar.

**Neni 19. Njoftimet.**

19.1 njoftimi për ortakun duhet të kryhet sipas adresës së përcaktuar në nenin 6 të këtij statute.

19.2 Ortaku është i detyruar të njoftojë ndryshimet në adresën e tij.

**Neni 20. Të ndryshme.**

20.1 Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

20.2 Shoqëria “OM Green Energy” SHPK, regjistrohet sipas ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.

20.3 Statuti u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë juridike.

**THEMELUES**

**MUHARREM BARDHOCI**

